

## THIRRJE PËR APLIKIME

Investime për diversifikimin e të ardhurave rurale dhe krijimi i vlerës së shtuar në zinxhirin e vlerës për produktet bujqësore lokale

**Financuar nga projekti**

**UNJP/ALB/017/UNJP**

*“Forcimi i kapaciteteve të fermerëve, grave rurale, të rinjve dhe shërbimit këshillimor”*

FAO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë dhe Ushqimin zhvilloi takimin informues të fermerëve dhe prodhuesit e vegjël (Seferan) për thirrjen për aplikime në kuadër të projektit.



Projekti, duke përfshirë edhe këtë thirrje për aplikim, synon të mbështesë fermerët dhe prodhuesit e vegjël përmes promovimit të praktikave më të mira në diversifikimin e të ardhurave rurale, krijimi i vlerës së shtuar në zinxhirin ushqimorë, bashkëpunimit të fermerëve për rritjen e standardeve të sigurisë ushqimore dhe promovimin e produkteve lokale.

Grupet e fermerëve nga komuniteti Seferan (dhe fshatrat përreth), janë të pranueshëm për këtë thirrje për aplikim, në masën “**Investime për rritjen e vlerës së produkteve lokale bujqësore**” e cila synon të mundësojë grante për investime në vlerë të vogël. **Çdo grant i dhënë në këtë thirrje nuk mund të kalojë vlerën e 20,000 USD.** Në këtë shumë nuk përfshihet bashkëfinancimi i grupit të fermerëve.

Thirrja për aplikim inkurajon bashkëpunimin midis fermerëve, përpunuesve të vogël dhe agroturizmit duke nxitur aplikantët të përfitojnë investime në grup, jo vetëm në nivel individual, u shpreh Z. Agim Pepkolaj (FAOAL).

Aplikimet duhen të plotësohet në mënyrë elektronike, forma e të cilës pranohet në gjuhën Shqipe ose Angleze, dhe rekomandohet të dërgohen dorazi në zyrën e FAO Shqipëri.

Afati i fundit për pranimin e aplikimeve **është 5 Prill 2021**